



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1611/4 prot.

Datë 12.07.2023

V E N D I M
Nr. 595/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.07.2023, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me numër 1611/2023 prot., datë 03.07.2023 si dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3255 datë 10.07.2023 për procedurën e prokurimit “E hapur” me tender kryesor nr REF-71219-05-31-2023 ku ankimon Lotin 2 me objekt “**LOTI 2 F.V. PAJISJE SPITALORE PER URGJENCEN E SPITALIT RAJONAL VLORE**” me nr REF-71223-05-31-2023 me fond limit 6,633,000.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 23-06-2023 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlore.

Ankimues:

Operatori ekonomik “*Trimed*” SHPK
Autostrada Tirane -Durrës , Km 10, Zone Kadastrale 2105,
Nr.Pasurie 95/11.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlore.
Lagjja : “ Partizani “

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të

Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020
“Rregullore për marrjen e masave organizative për
ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të
Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar
nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në
tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e ulët
monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me
pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Rregullat e Prokurimit
Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye
legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi
pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01-06-2023 , është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e
prokurimit “*E hapur*” me tender kryesor nr REF-71219-05-31-2023 ku ankimon Lotin 2 me
objekt “**LOTI 2 F.V. PAJISJE SPITALORE PER URGJENCEN E SPITALIT RAJONAL
VLORE**” me nr REF-71223-05-31-2023 me fond limit 6,633,000.00 leke pa TVSH, zhvilluar
me datë 23-06-2023 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlore.

II.2 Në datën 10.07.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur në mënyrë
elektronike në Sistemin e Ankesave Elektronike ankesa me nr. A/2023/3255 , protokolluar me
nr. 1611/2023 datë 10.07.2023 e operatorit ekonomik “*Trimed*” SHPK , duke kundërshtuar
skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin
Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të
dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të
plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të
procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1611/2 prot., datë 11.07.2023.

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues “Trimed” SHPK për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2023//3255 datë 10.07.2023 dhe nr. 1611/2023 prot., datë 10.07.2023 për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për ankesën e operatorit ekonomik “Trimed” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me tender kryesor nr REF-71219-05-31-2023 ku ankimon Lotin 2 me objekt “**LOTI 2 F.V. PAJISJE SPITALORE PER URGJENCEN E SPITALIT RAJONAL VLORE**” me nr REF-71223-05-31-2023 me fond limit 6,633,000.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 23-06-2023 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlore.
2. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Trimed” SHPK
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

